

VENDIM NR. 41/1, DATË 28/07/2025

I

ASAMBLEË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "FINMAN" SHPK

Në Sëlinë e Shoqërisë "FINMAN" Sh.P.K. me nr. NIPT-i: **L62405030K**, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Ortakëve në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, Datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjit Nr. 9723, Datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Ligjit Nr. 25/2018, Datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", e cila


VENDOSI

- Të emërojë Z. Mirgen DERVISHI me NID I51205043G dhe Nr. Liçense 485 (Eksperti Kontabël) për të kryer procedurat për shtimin e kapitalit të shoqërisë.
- Depozitim të këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- Autorizohet Z. Fesbian Myftari me cilësinë e Përfaqësuesit Ligjor të Shoqërisë ti komunikojë Z. Mirgen DERVISHI këtë vendim.

PER SHOQERINE "FINMAN" SH.P.K.

ORTAKET

Sadik ISMAILAJ



Shoqeria "MOTUS" SHPK
Perfaqesuar nga Administratori


Edmond SPAHIU



Rajmonda AGALLIU



Jonuz ISMAILAJ



VENDIM NR. 41, DATË 28.07.2025
I ASAMBLESE SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "FINMAN" SHPK

Sot më Datë 28.07.2025, në Selinë e Shoqërisë "FINMAN" SHPK, me adresë Tirane, Sheshi "Italia", Arena Center, Seksioni D, Kati 5, 1000, me nr. NIPT-I L62405030K, u mbledh Asambleja e Përgjithshme dhe merret ky vendim nga Ortakët e Shoqërisë, me pjesëmarrjen e mëposhtme:

- Rajmonda Agalliu, zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 14.5% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, e pranishme personalisht;
- Sadik Ismailaj, zotërues i një kuote e cila përfaqëson 9% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, i pranishëm personalisht;
- Jonuz Ismailaj, zotërues i një kuote e cila përfaqëson 19.5% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, i pranishëm personalisht;
- Shoqëria "MOTUS" SHPK, zotëruese e një kuote e cila përfaqëson 57% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë, përfaqësuar nga Administratori, Z.Edmond Spahiu,

të cilët sëbashku zotërojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

Në bazë të regjistrimit të Aktit të Themelimit regjistruar në QKB me datë 05.12.2016 rezulton e regjistruar shoqëria Holding "FINMAN" SHPK, me NIPT L62405030K me aktivitet koordinimin teknik, administrativ, financiar dhe organizativ të shoqërive të grupit.

Rendi i dites i njoftuar për t'u diskutuar në këtë mbledhje është:

- Miratimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2024;*
- Destinimi i rezultatit financiar të vitit ushtrimor 2024;*
- Destinimi i fitimeve të akumuluar deri në vitin ushtrimor 2023;*
- Te tjera.*

Në fund të mbledhjes, me unanimitet të asambleja,

VENDOSI:

1. Miratimin e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2024 së bashku me shënimet përkatëse sqaruese.
2. Destinimin e fitimit të vitit ushtrimor 2024 në shumën prej **8,575,795,349 Lekë (tetë miliard e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzetë e nëntë lekë)**, sipas përcaktimit vijues:
 - Pjesa e fitimit neto në vlerën **8,375,795,349 Lekë (tetë miliard e treqind e shtatëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e treqind e dyzetë e nëntë Lekë)** do të kalojnë për shtim kapitali;
 - Pjesa e mbetur fitimit neto në vlerën **200,000,000 Lekë (dyqind milion Lekë)** do të mbartet për vitet e ardhshme;

3. Fitimet e akumuluarra deri në vitin 2023 në vlerën prej **2,830,287,301 Lekë (dy miliard e tetëqind e tridhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e një Lekë)** do të kalojnë për shtim kapitali.
4. Depozitimin e këtij Vendimi Pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.


Pasi nuk pati çështje të tjera për të diskutuar, mbledhja u deklarua e mbyllur.

ORTAKËT:

Sadik ISMAILAJ



Rajmonda AGALLIU



Shoqeria "MOTUS" SHPK
Perfaqesuar nga Administratori
Edmond SPAHIU



Jonuz ISMAILAJ



VENDIM
Nr. 45, Datë 15/08/2025
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
TE SHOQERISE "FINMAN" SH.P.K.

Në Selinë e Shoqërisë "FINMAN" SH.P.K. me nr. NIPT-i: **L62405030K**, u zhvillua mbledhja për të shqyrtuar raportin e paraqitur nga Eksperti Kontabël i Autorizuar, për rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë nëpërmjet rikapitalizimit të fitimit të akumuluar dhe të pashpërndarë nga ana e shoqërisë gjendje të datës 31.12.2024, dhe në përfundim

VENDOSI:

- Miratimi i raportit të paraqitur nga Eksperti Kontabël i Autorizuar Z. Mirgen Dervishi, për vlerësimin e rezervave dhe fitimeve të pashpërndara për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë gjendje më 31/12/2024.
- Zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë "FINMAN" SH.P.K., sipas mënyrës së përcaktuar në raport për 11,206,082,650 lekë nga :
 - Nga fitimi i pashpërndarë për 2,830,287,301 lekë,
 - Nga fitimi i vitit për 8,375,795,349 lekë.
- Zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë "FINMAN" SH.P.K., nga 89,000,000 lekë, bëhet 11,295,082,650 lekë.
- Pas rritjes së kapitalit themeltar pjesëmarrja e ortakëve të shoqërisë mbetet e pandryshuar. Kapitali zotërohet 100 % nga ortakët e shoqërisë si më poshtë:
 1. MOTUS Sh.p.k. me 1 kuotë, 57% të kapitalit, në vlerën 6,438,197,110.50 lekë
 2. Z. Jonuz Ismailaj me 1 kuotë, 19.5% të kapitalit, në vlerën 2,202,541,116.75 lekë
 3. Znj. Rajmonda Agalliu me 1 kuotë, 14.5% të kapitalit, në vlerën 1,637,786,984.25 lekë
 4. Z. Sadik Ismailaj me 1 kuotë, 9% të kapitalit, në vlerën 1,016,557,438.50 lekë.
- Depozitim e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ngarkohet administratori i shoqërisë Z. Fesbian Myftari të ndjek procedurat ligjore për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

PER SHOQERINE "FINMAN" SH.P.K.

ORTAKET

Sadik ISMAILAJ

Shoqeria "MOTUS" SHPK
Perfaqesuar nga Administratori

Edmond SPAHU

Rajmonda AGALLIU

Jonuz ISMAILAJ

